



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 8357 prot.

Roskovec, më 21.10.2025

VENDIM

Nr. 54, datë 30.09.2025

PËR

**KALIMIN E PASURISË SHTETËRORE NË PRONËSI NGA BASHKIA ROSKOVEC
TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT NË FUNKSION TË
POSTËS SË POLICISË ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 3, 8, 9 pika 1.2, 18 dhe 54 shkronja “e” të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të neneve 5 dhe 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; Ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 26.7.2018 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Roskovec” dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 455, datë 10.7.2024 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (Faza 1)”, Bashkia Roskovec”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr. 64, datë 17.08.2018 “Për kryerjen e procedurave të shpronësimit për projektin “Rehabilitim i bllokut Urban nr.2 Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35 datë 13.06.2016 “Për miratimin e projektit të investimit me objekt “Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68 datë 26.09.2017 “Për miratimin e projektit me objekt “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr.2 Qendra e qytetit Roskovec”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 31.10.2023 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjesë të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1)”; Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 20.07.2017 ndërmjet Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkisë Roskovec “Për dakordësinë institucionale midis dy institucioneve, DVP Fier dhe Bashkisë Roskovec “Mbi përcaktimin e objektit që do të shërbejë për sistemimin e SP

Roskovec, deri në përfundimin e investimit”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 47, datë 31.07.2024 “Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec” ; si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (nr 7213/2 prot, datë 07.08.2024) dhe Bashkisë Roskovec (nr 6241 prot, datë 07.08.2024) me objekt: “Për Ndërtimin e Postës së Policisë Roskovec”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të miratohet kalimi i sipërfaqes së tokës sipas planvendosjes bashkëngjitur nga Bashkia Roskovec në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për qëllime institucionale dhe të shërbimit të rendit publik, në funksion të objektit të ndërtuar “Posta e Policisë Roskovec”, konkretisht 2112 m² nga e cila 1510 m² në pasurinë me nr.352/21, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025128 dhe 602 m² në pasurinë me nr.352/23, zona kadastrale 3196, kodi unik 3196025130.
2. Sipërfaqja e tokës e përcaktuar në pikën 1, hiqet nga sipërfaqja e pronave të paluajtshme që ka në pronësi bashkia sipas Certifikatave të Pronësisë lëshuar nga ASHK bashkëngjitur.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Roskovec për zbatimin e këtij vendimi dhe për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në bashkëpunim me institucionet qendrore përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

